

# STATUTI I SHOQERISE AKSIONARE

## "ABT" SH.A

### KAPITULLI I: KRIJIMI, FORMA, EMRI, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, KAPITALI, AKSIONET

Sot me date 21.10.2022 me cilesine e aksionarit themelues: Z. Aleksander Binjaku me Nr. Personal G60131093E, banues ne Tirane.

Ka vendosur krijimin e shoqerise "ABT" SH.A me termat e meposhtem.

#### Neni 1

##### Shoqeria 1.1

Emri i Shoqerise eshte "ABT" SH.A e pasuar ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Sh.A.", qe perfaqeson formen e saj ligjore, ne vijim referuar si "Shoqeria".

1.2 Shoqeria eshte nje person juridik Shqiptar qe ka formen ligjore te shoqerise aksionare me oferte private, sipas parashikimeve te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar ("Ligji per Shoqerite Tregtare").

1.3 Aksionaret e Shoqerise gezojne pergjegjesi te kufizuar den i ne kufirin e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise, te perfaqesuar nga aksionet.

1.4 Ne te gjitha dokumentat, faturat, reklamat, dhe publikimet e leshuara nga Shoqeria, pavaresisht mjetit te trasmetimit, emri i Shoqerise do te paraprihet ose do te ndiciet nga fjalet si ne vijim: a. fjalet "Shoqeri Aksionare" ose "Sh.A.", b. numri i saj unik i indentifikimit (NUIS) c. selia e saj, d. fakti nese Shoqeria eshte ne likuidim, nese eshte rasti.

#### Neni 2

##### Selia

2.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Elbasan, Shushice, Hajdaran, Lagjja Shenkoll, Rruga Thoma Kalefi, zona kadastrale nr 1919, ndertese private nje kateshe me nr pasurie 118/1, prane fabrikes tullave Pojan.

2.2 Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj brenda territorit te Republikes se Shqiperise. Ajo mund te hape zyra, filiale, agjenci ose te ofroje sherbime ne gjithe territorin e Shqiperise me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve.



### **Neni 3**

#### **Objekti**

3.1 Objekti kryesor i aktivitetit te Shoqerise eshte: -

Tregtim i vajrave lubrifikante, tregtimi i hidrokarbureve brenda e jashte vendit; - import-eksport dhe tregti me shumice e pakice e naftes, gazit, nenprodukteve te tyre. Tregtim, import-eksport i te gjitha llojeve te qymyreve dhe bitumeve.

3.2 Ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe licencat e Shoqerise te leshuara nga autoritetet kompetente, Shoqeria mund te kryeje cdo veprimtari qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi, apo qe ndervaret ose lidhet me aktivitetet e renditura me siper.

3.3 Objekti i shoqerise mund te ndryshohet dhe/ose shtohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve.

3.4 Shoqeria do te bashkepunoje me persona fizike ose juridike te cilet ushtrojne te njejten veprimtari ne Shqiperi dhe/ose jashte saj.

### **Neni 4**

#### **Kohezgjatja e Shoqerise**

4.1 Kohezgjatja e Shoqerise eshte e pakufizuar duke filluar nga dita e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

### **Neni 5**

#### **Aksionari**

5.1 Aksionari i vetem i Shoqerise eshte Z. Aleksander Binjaku me Nr. Personal G60131093E banues ne Tirane.

### **Neni 6**

#### **Kapitali Themeltar dhe Kontributet ne Kapital**

6.1 Kapitali aksionar i Shoqerise eshte 3.500.000 leke.

6.2 Kapitali aksionar i shoqerise eshte ndare ne 1 kuote me vlere te pergjithshme 3.500.000 leke  
Aksionari themelues i Shoqerise eshte Z. Aleksander Binjaku zoterues i 100 % te aksioneve me vlere nominale prej 3,500,000 leke

6.3 Cdo aksion i zakonshem i jep zoteruesit te tij te drejta vote ne raport proporcional me pjesen e kapitalit qe perfaqeson aksioni.



6.4 Aksionari ka shlyer 1/4 e vleres se kapitalit te nenshkuar ne menyre proporcionale me pjesemarrjen ne Shoqeri ne llogarine e Shoqerise sic parashikohet ne ligj dhe do vijoje te shlyje vlerat perkatese sipas dispozitave ligjore dhe Statutit. 25% e vleres se kontributeve do te paguhet menjehere ne banke.

## **Neni 7**

### **Zmadhimi i Kapitalit**

7.1 Asambleja e Pergjithshme mund te vendose zmadhimin e kapitalit te Shoqerise ne perputhje me kete Statut dhe Ligjin "Per Shoqerite Tregtare".

7.2 Shoqeria do te njoftoje Qendren Kombetare te Biznesit ("QKB") per vendimin e miratuar lidhur me zmadhimin e kapitalit aksionar, ne perputhje me afatet e parashikuara nga Ligji per QKB (Ligji Nr. 131/2015 PER QENDREN KOMBETARE TE BIZNESIT). Pas perfundimit te nenshkrimet te aksioneve dhe shlyerjes se te pakten nje te treten se vleres nominale te aksioneve te nenshkuara per kontributet ne para /fizike brenda afateve te kerkuara, Shoqeria do te rregjistroj prane QKB zmadhimin e kapitalit te realizuar. Zmadhimi i kapitalit do te hyje ne fuqi ne daten e rregjistrimit te realizuar prane QKB.

## **Neni 8**

### **Akti i Emetimit te Aksioneve**

8.1 Aksionet e Shoqerise emetohen mbi bazen e Aktit te Emetimit, i cili nniratohet nga Administratori ne lidhje me pjesen e realizuar te zmadhimit te kapitalit aksionar, mbasi te kete hyre ne fuqi zmadhimi i kapitalit. Aksionet e reja nuk mund te emetohen dhe te drejtat te lidhura me to nuk mund te transferohen perpara hyrjes ne fuqi te zmadhimit dhe miratimit te Aktit te Emetimit.

8.2 Akti i Emetimit duhet te permbaje te dhenat e kerkuara nga Ligji per Shoqerite Tregtare.

## **Neni 9**

### **Zvogelimi i Kapitalit**

9.1 Asambleja e Pergjithshme mund te vendos mbi zvogelimin e kapitalit themeltare te Shoqerise. Ne rastin kur zvogelimi i kapitalit nuk eshte kryer me qellim mbulimin e humbjeve, Asambleja e Aksionareve mund te vendos gjithashtu anulimin e aksioneve, ne perputhje me parashikimet e Ligjit per Shoqerite Tregtare (vecanterisht nenit 149)

## **Neni 10**

### **Rregjistri i Aksioneve**

10.1 Administratori do te mbaje regjistrin e aksioneve, me qellim pasqyrimin e cdo te drejte te aksionareve apo paleve te treta mbi aksionet e Shoqerise ("Regjistri i Aksioneve"). Regjistri i Aksioneve duhet te permbaje te dhenat e kerkuara nga Ligji per Shoqerite Tregtare.



10.2 Aksionaret e regjistruar ne Regjistrin e Aksioneve prezumohen te jene aksionare kundrejt Shoqerise dhe te tretteve. Pronesia mbi aksionet dhe cdo e drejte e lidhur me to, nuk mund te ushtrohet kundrejt Shoqerise apo paleve te treta, perpara regjistrimit te kesaj pronesie ne Regjistrin e Aksioneve te mbajtur nga Shoqeria.

10.3 Secili nga aksionaret gezon te drejten, nepermjet paraqitjes se nje kerkese me shkrim, per tu pajisur me ekstraktin e Regjistrit te Aksioneve qe mban vulen e Shoqerise.

10.4 Administratori duhet te raportoje, brenda afateve te kerkuara, cdo ndryshim te te dhenave te regjistruara ne Regjistrin e Aksioneve te Shoqerise, ne perputhje me kerkesat e legjislacionit ne fuqi dhe vecanerisht njoftimin e listes se aksionareve sipas parashikimeve te Ligjit per QKB, si edhe regjistrimin e aksioneve ne perputhje me Ligjin nr. 9879, date 21.02.2008 "Per Titujt" (ne rastin kur ky regjistrim kerkohet me ligj).

## **Neni 11**

### **Transferimi i Aksioneve**

11.1 Aksionet jane te formes nominale dhe lirisht te transferueshme sipas dispozitave te ligjit "Per shoqerite tregtare".

11.2 Aksionet dhe te drejtat e fituara si rezultat i transferimit te aksioneve nuk mund te ushtrohen kundrejt Shoqerise apo paleve te treta, perpara se ky transferim te regjistrohet prane Regjistrit te Aksioneve.

## **KAPITULLI II: ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHOQERISE**

## **Neni 12**

### **Sistemi me dy nivele**

12.1 Vendimmarrja dhe administrimi i Shoqerise eshte strukturuar sipas sistemit me dy nivele, ne perputhje me Pjesen V, Titulli IV, Kapitulli III i Ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

12.2 Organet drejtuese te Shoqerise jane:

- a. Asambleja e Pergjithshme;
- b. Keshilli Mbikeqyres;
- c. Administratori



## Neni 13

### Asambleja e Pergjithshme

13.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise.

13.2 Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e meposhtme te shoqerise: a. Percaktimin e politikave tregtare te Shoqerise, per zhvillimin e veprimtarise tregtare te Shoqerise; b. Miratimin e strategjise dhe planeve financiare te Shoqerise, si dhe te cdo ndryshimi te tyre; c. Ndryshimin e Statutit; d. Zgjedhjen, shkarkimin dhe pranimin e doreheqjes te anetareve te Keshillit Mbikeqyres dhe miratimin e skemes se shperblimit te tyre; e. Zgjedhjen dhe shkarkimin e eksperteve kontabel te rregjistruar dhe te likuiduesve. f. Miratimin e pasqyrave financiare, dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise, dhe ndryshimeve ne politikat kontabele te Shoqerise; g. Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; h. Pjesetimin, terheqjen, anulimin, riblerjen dhe rifitimin e aksioneve; i. Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit te Shoqerise; j. Transformimi (duke pershire bashkimin, ngrirjen, ndarjen, ndryshimin e formes ligjore apo riorganizime te tjera te shoqerive), prishjen dhe likuidimin e Shoqerise, dhe k. ceshtje e problematika te tjera te parashikuara nga Ligji per Shoqerite Tregtare apo ne kete dokument.

13.3 Asambleja e Zakonshme e Aksionareve, ka te drejte te marre cdo vendim me perjashtim te atyre vendimeve qe parashikohen ne nenin 145 (1) te Ligji Per Shoqerite Tregtare te chat jane ne kompetence te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionareve.

13.4 Asambleja e Zakonshme e Aksionareve merr vendime te vlefshme vetem nese ne te marrin pjese personalisht ose te perfaqesuar me prokure aksionaret qe zoterojne me shume se 30% te aksioneve te nenshkruar me te drejte vote. Ne qofte Asambleja e Zakonshme e Aksionareve nuk mund te mbahet per shkak te mungeses se kuorumit, mbledhja do te ri-thirret brenda 30 diteve me te njejten rend dite.

13.5 Asambleja e Zakonshme e Aksionareve merr vendime me nje shumice te thjeshte te aksionareve pjesemarres.

13.6 Asambleja e Zakonshme e Aksionareve mblidhte te pakten nje here ne vit brenda 6 (gjashte) muajve pas mbylljes se vitit financiar.

13.7 Ndryshimi i Statutit te Shoqerise, shperndarja e fitimeve, dhe shkrirja e Shoqerise jane ne diskrecion te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionareve.

13.8 Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve, ne perputhje me nenin 18.2 me poshte, mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ne te marrin pjese personalisht ose nepermjet nje perfaqesuesi me prokure aksionaret qe zoterojne me shume 50% e aksioneve te nenshkruara me te drejte vote. Ne qofte Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve nuk mund te mbahet per shkak te mungeses se kuorumit, mbledhja do te ri-thirret brenda 30 diteve me te njejten rend dite.

13.9 Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve merr vendime me nje shumice te cilesuar, prej 3/4 te votave te aksionareve pjesemarres.



## **Neni 14**

### **Thirrja e Asamblese se Pergjithshme**

14.1 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara ne Ligjin per Shoqerite Tregtare, nga ligje te tjera, ose nga dispozitat e statutit dhe sa here cie mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme, mbahet ne seline e Shoqerise, ose ne cdo vend tjeter per te cilin eshte rene dakort nga vete ajo, ose nga Keshilli Mbikqyres.

14.2 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nga Aksionari, nga anetaret e Keshillit Mbikqyres ose nga Administratori. Mbledhja mund te thirret gjithashtu nga eksperti kontabel i autorizuar ne rastet kur parashikohet nga legjislacioni ne fuqi.

14.3 Asambleja e Pergjithshme do te thirret te pakten nje here ne vit, per te aprovuar llogarite vjetore, brenda 6 muajve nga mbarimi i vitit ushtrimor si dhe per te ushtruar cdo kompetence qe i jep ligji.

14.4 Thirrja e Asamblese se Pergjithshme eshte e detyrueshme ne rastin e ngjarjeve te parashikuara nga neni 136 i Ligjit per Shoqerite Tregtare.

14.5 Asambleja e Pergjithshme e Aksionareve thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me poste elektronike. Njoftimi me shkrese ose poste elektronike dhe rendi i dites per mbledhjen duhet u dorezohet te gjitha aksionareve jo me vonese 21 dite perpara dites se paracaktuar te mbledhjes.

## **Neni 15**

### **Keshilli Mbikqyres**

15.1 Keshilli Mbikqyres eshte organi i shoqerise i ngarkuar me mbikqyrjen e veprimtarise se Administratorit sipas politikave te Shoqerise, neneve te ketij Statuti dhe te legjislacionit te zbatueshem.

15.2 Keshilli Mbikqyres ka per detyre te:

a. Te jape direktiva per Administratorin per zbatimin e politikave te shoqerise.

b. Vezhgoje dhe mbikqyre zbatimin e politikave tregtare te Shoqerise nga Administratori;

dhe c. Pergatise, me kerkese te Asamblese se Pergjithshme masa te cilat jane ne kompetencen e kesaj te fundit; te rekomandoje vendime per t'u marre nga Asambleja e Pergjithshme, dhe te ekzekutoje vendimet e saj.

15.3 Keshilli Mbikqyres eshte kompetent te:

a. Therrase Asamblene e Pergjithshme sa here kjo konsiderohet e nevojshme per interesat e Shoqerise dhe menjehere pas verifikimit te rrethanave te parashikuara nga pikat 3, 4 dhe 5 te nenit 136 te Ligjit per Shoqerite Tregtare;

b. Siguroje qe Shoqeria zbaton ligjet dhe standardet e zbatueshme te kontabilitetit;

c. Shqyrtoje librat e Shoqerise, dokumentet dhe asetet;

d. Siguroje qe pasqyrat vjetore te kontabilitetit dhe raporti i performances se

Shoqterise te perгатiten ne menyre te rregullt nga Administratori, dhe qe ky i fundit te permbushe cdo detyrim tjeter ligjor apo statutor per raportim apo publikim. Keto dokumente duhen miratuar e nenshkruar nga te gjitha anetaret e Keshillit Mbikeqyres, per t'i paraqitur ne Asamblene e Pergjithshme se bashku me nje raport te Keshillit Mbikeqyres ne lidhje me arsyet e miratimit dhe nje pershkrim te menyrave se si eshte monitoruar administrimi gjate vitit financiar; dhe

e. Siguroje qe auditimi i librave dhe i regjistrave te kryhet te pakten cdo vit nga nje ekspert kontabel pavarur dhe qe raporti i auditorit drejtuar Asamblese se Pergjithshme t'i jete vene ne dispozicion cdo anetari te Keshillit Mbikeqyres. Raporti i Keshillit sipas gernes se meparshme (d) duhet te permbaje gjithashtu mendimin e Keshillit mbi raportin e auditimit.

f. Te krijoje komitete te perhershme apo te posagme, per ceshtje te ndryshme operationale te shoqerise; 9. Te emeruje dhe te liroje nga detyra Administratorin e Shoqerise.

h. Te percaktoje shperblimin e administratoreve;

l. Te kryeje veprimet e tjera, te percaktuara ne ligj dhe ne Statut

## **Neni 16**

### **Perberja e Keshillit Mbikeqyres**

16.1 Keshilli Mbikeqyres perbehet nga 3 (tre) anetare, te cilet emerohen nga Asambleja e Pergjithshme.

16.2. Anetaret e pare te Keshillit Mbikeqyres do te jene:

• Aleksander Binjaku shtetas shqiptar, i datelindjes 31.01.1966, mbajtes i kartes se identitetit me nr. 032593877 dhe nr. personal G60131093E.

• Nerajda Alushaj shtetase shqiptare, e datelindjes 27.02.1985, mbajtes i kartes se identitetit me nr. 036810488 dhe nr. personal I55227060W.

• Athina Binjaku shtetase shqiptare, e datelindjes 12.04.1962, mbajtes i kartes se identitetit me nr. 033856781 dhe nr. personal G25412170G.

16.3 Anetaret e Keshillit Mbikeqyres e mbajne postin e tyre per nje periudhe prej 3 (tre) vjetesh, ne perfundim te se dies ata mund te ri-emerohen.

16.4 Anetaret e Keshillit Mbikeqyres Jane individe, te cilet duhet te jene te pavarur dhe te ndryshem nga administratoret e shoqerise, administratoret e shoqerive te tjera te te njejtut grup, si dhe personat e lidhur me personat e mesiperm. Anetare te pavarur te Keshillit Mbikeqyres vleresohen personat, te diet nuk kane konflikt interesash apo anetaresie, sipas percaktimeve te pikes 3 te nenit 13 dhe te pikes 3 te nenit 167 te Ligjit per Shoqerite Tregtare. Cdo emerim, i bere ne kundershtim me keto parashikime

është absolutisht i pavlefshëm. Anetaret e Keshillit Mbikqyres detyrohen të informojnë menjëherë Shoqerine për çdo konflikt interesi, e anëtarësi në keshillat e shoqerive të tjera.

16.5 Cdo vend i mbetur vakant në Keshillin Mbikqyres si pasoje e dorëheqjes, shkarkimit, paaftësisë apo vdekjes, do të plotësohet nga një anëtar i ri i emëruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Anëtar i ri do të mbetet në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të zëvendësuar.

16.6 Keshilli Mbikqyres zgjedh Kryetarin ndërmjet anëtarëve të tij Si dhe sekretarin e Keshillit Mbikqyres.

16.7 Përveç sa përcaktohet në këtë Nen, anetaret e Keshillit Mbikqyres duhet të plotësojnë kushtet, detyrimet, përgjegjësitë dhe kriteret e parashikuara në nenet 163 nga (1) në (3) dhe 167 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

## **Neni 17**

### **Procesi Vendimarrës i Keshillit Mbikqyres**

17.1 Keshilli Mbikqyres mund të zhvillojë mbledhjet e tij në Republikën e Shqipërisë, në një vend të caktuar nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres. Nëse nuk caktohet asnjë vend tjetër, Keshilli Mbikqyres do të zhvillojë mbledhjet e tij në selinë zyrtare të Shoqërisë.

17.2 Keshilli Mbikqyres do të mbledhet të paktën gjatë here në vit. Cdo mbledhje tjetër e Keshillit Mbikqyres zhvillohet me kërkesë të Kryetarit, një anëtar i Keshillit Mbikqyres ose të Administratorit.

17.3 Mbledhja mund të thirret nga Kryetari, me iniciativën e tij/saj ose me kërkesë të një anëtar tjetër të Keshillit Mbikqyres apo të Administratorit. Si rregull thirrja duhet të bëhet 7 (shtatë) ditë përpara me leter, faks ose cdo komunikim elektronik të besueshëm, por thirrja mund të jetë edhe vërfshime edhe verbalisht dhe pa afat, në qoftë se anetaret e Keshillit Mbikqyres e pranojnë atë. Cdo njoftim thirrje duhet të tregojë çështjet kryesore të rendit të ditës.

17.4 Procesverbalet e mbledhjeve të Keshillit Mbikqyres mbahen në formë dhe në përmbajtjen e përcaktuar në nenin 161 (3) të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

17.5 Vendimet e Keshillit Mbikqyres janë të vërfshme në rast se me shumicë të anëtarëve të tij janë të pranishëm personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve. Nëse ky kuorum nuk arrihet, mbledhja shtyhet për një datë tjetër. Keshilli Mbikqyres vendos me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast barazimi votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare. Si përjashtim nga ky rregull, Keshilli Mbikqyres vendos me unanimitet mbi rregulloren e brendshme të Keshillit.

17.6 Një anëtar i Keshillit Mbikqyres nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës në rastet e parashikuara nga neni 162 (3) i Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

17.7 Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres mund gjithashtu të drejtohen nëpërmjet telekonferencës apo videokonferencës, ose nëpërmjet menyrave të tjera elektronike të ngjashme, me kusht që të gjithë





pjesemarrsit te identifikohen rregullisht dhe te mund te ndjekin diskutimin dhe te mund te marrin pjese ne menyre aktive ne te.

17.8 Keshilli Mbikqyres mund te kerkoje pjesemarrjen e Administratorit ne mbledhjet e tij dhe te kerkoje nga Administratori te gjithë dokumentacionin e nevojshem per te kryer detyrat dhe permbushur detyrimet e tij.

## **Neni 18**

### **Administrimi i Shoqerise**

18.1 Shoqeria administrohet nga nje Administrator i cili autorizohet te ushtroje te gjitha kompetencat ekzekutive te dhena nga ligji dhe/ose nga ky Statut.

18.2 Administratori zgjidhet nga Keshilli Mbikqyres me shumice te thjeshte.

18.3 Ne rast se pozicioni i Administratorit mbetet vakant si pasoje e doreheqjes, shkarkimit, paaftesise apo vdekjes, atehere Keshilli Mbikqyres do te zgjedhe brenda 10 (dhjete) diteve Administratorin e ri.

18.4 Me pranimin e zgjedhjes se tij, Administratori pranon se marredhenia e tij me Shoqerine jane marredhenie kontraktuale sipas legjislacionit ne fuqi.

18.5 Administratori kryen dhe detyra te tjera te chat mund t'i jepen here pas here nga Asambleja e Pergjithshme ose nga Keshilli Mbikqyres, ne perputhje me kete Statut dhe me ligjin.

18.6 Administratori duhet te zbatoje kriteret, parimet, parashikimet, kufizimet, perjashtimet dhe pergjegjesite e parashikuara ne Ligjin per Shogerite Tregtare dhe ne vecanti me parashikimet e nenit 167 te ketij ligji.

## **Neni 19**

### **Kompetencat e Administratorit**

19.1 Administratorit eshte i ngarkuar me administrimin dhe perfaqesimin e Shoqerise.

19.2 Administratori do te vendose per cdo geshtje qe nuk eshte kompetence ekskluzive e Asamblese e Pergjithshme ose e Keshillit Mbikqyres. Ne vecanti, Administratori ka kompetencen dhe detyren qe te:

- Administroje Shoqerine duke zbatuar politikat e saj;
- Te perfaqesoje Shoqerine ne raport me palet e treta;
- Siguroje mbajtjen dhe administrimin e duhur te librave dhe dokumenteve te kontabilitetit;
- Te kujdeset per pergatitjen, e te nenshkruaje pasqyrat financiare vjetore dhe bilancin dhe raportin e performances, e t'ia paraqese ato per miratim Keshillit Mbikqyres e me pas Asamblese se Pergjithshme, se bashku me propozimin per shperndarje te fitimeve apo mbulime te humbjeve;
- Krijoje nje sistem monitorimi te hershem per zhvillime qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- Raportoje prane Keshillit Mbikqyres ne lidhje me zbatimin e politikave te biznesit dhe per realizimin e transakcioneve me rendesi te vecante per performancen e Shoqerise;
- Kryeje cdo regjistrim ose

publikim te te dhenave te Shoqerise qe kerkohet nga Ligji per Shoqerite Tregtare, apo ligje te tjera ne fuqi; h. Kryeje detyra te tjera te parashikuara nga ligji ose nga ky Statut; dhe Njoftoje menjehere Kryetarin e Keshillit Mbikeqyres dhe Asamblene e Pergjithshme ne rastet e parashikuara nga pikat 3, 4 dhe 5 te nenit 136 te Ligjit per Shoqerite Tregtare Administratori ka te drejte qe brenda kompetencave te tij t'u jape nje ose disa punonjesve te shoqerise, te drejten per te kryer veprime te vecanta apo kategori veprimesh, me te drejten e nendeleq i mit.

19.3 Aktet me te chat Shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve, duhet te nenshkuhen nga Administratori, ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per keto akte

**19.4 Administratori i pare i Shoqerise eshte Znj Nerajda Alushaj shtetase shqiptare, e datelindjes 27.02.1985 mbajtes i kartes se identitetit me nr. 036810488 dhe nr. personal I55227060W.**

19.5 Administratori i Shoqerise eshte emeruar per nje periudhe 3(tre) vjecare me te drejte rizgjedhje.

### **KAPITULLI III: KONTROLLI I SHOQERISE**

#### **Neni 20**

##### **Eksperti Kontabel**

20.1 Asambleja e Pergjithshme emeron ekspertin kontabel te Shoqerise. per cdo vit financiar me kompetencat, por jo vetem, te meposhtme: Ndhme ne mbajtjen e llogarive me ciellim qe te jene ne perputhje me parimet kryesore te kontabilitetit; Pergatitja e raporteve vjetore me te dhena ekonomike (bilancet, llogarite e fitimit dhe humbjeve dhe dokumente te tjera qe lidhen me to) dhe dhena e mendimeve nese te dhenat ekonomike reflektojne gjendjen ekonomike aktuale te shoqerise.

20.2 Mandati i ekspertit kontabel eshte nje vit, i cili perputhet me vitin financiar te Shoqerise.

**20.3 Eksperti Kontabel i pare i caktuar nga Aksionari themelues do te jete Z. Mihal Qosja, lindur me 08.03.1962 ne Valesh, Elbasan, me ID Nr. G20308225H, dhe Nr. License 330 dt. 28.03.2014.**

#### **Neni 21**

##### **Librat e Shoqerise**

21.1 Shoqeria duhet te mbaje ibrat e kerkuar nga ligji ne te cilet regjistrohen llogarite vjetore, pasqyrat financiare vjetore, bilancet vjetore, raportet ekonomike vjetore te diet duhet te permbajne cdo gje qe parashikohet nga ligji.

21.2 Librat e Shoqerise si dhe pasqyrat financiare, bilancet vjetore dhe raportet financiare vjetore mbahen ne gjuhen Shqipe dhe ne monedhen Lek.



## Neni 22

### Viti Financiar

22.1 Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhjete) muajsh duke filluar qe nga data 1 Janar deri ne daten 31 Dhjetor.

## Neni 23

### Rezerva e Domosdoshme Ligjore

23.1 Rezerva e domosdoshme ligjore krijohet nga te pakten 5 per qind e fitimit neto qe mbetet pas zbritjes se humbjeve te viteve te kaluara. Nje procedure e tile nuk eshte e detyrueshme kur fond i rezerve behet sa 1/10 e kapitalit aksionar.

## KAPITULLI IV: DISPOZITA TE PERGJITHSHME

## Neni 24

### Shperndarja, Ligji i Zbatueshem, Gjuha:

24.1 Shoqeria shperndahet dhe do te likuidohet ne perputhje me Ligjin Tregtar dhe ligje te tjera te zbatueshme.

24.2 Per ceshtjet qe nuk parashikohen shprehimisht ne kete Statut zbatohen dispozitat e Ligjit Tregtar.

24.3 Ky Statut mund te ndryshohet ose zevendesohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

24.4 Aksionaret, anetaret e Keshillit Mbikeqyres dhe Administratori do te veprojne ne perputhje me parimet e Ligjit per Shoqerite Tregtare, e ne vecanti do te veprojne me kujdes ne perputhje me dispozitat e Pjeses I, Kreu IV te ketij ligji.

24.5 Ky Statut hyn ne fuqi ne momentin e miratimit nga Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise.

24.6 Ky Statut hartohet dhe nenshkruhet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe.

## AKSIONARI THEMELUES I SHOQERISE

Aleksander Binjaku

*Aleksander Binjaku*

Elbasan me 21.10.2022